

## KRITIKA E RECENSIONE

**Dr Bojka Sokollova, ALBANSKI VEZRAŽDENSKI PEČAT V BULGARIJA. BAN — Institut za Balkanistika, Sofija 1979, 200**

Bojka Sokollova punëtore e shkencës pranë Institutit Ballkanologjik në Sofje merret me çështje të Kulturës Shqiptare, me gjuhën, letërsinë dhe lëvizjen kombëtare shqiptare. Ka doktoruar në problemin e gjuhës dhe të kulturës të shqiptarëve të fshatit Mandricë, që është i banuar me shqiptarë në Bullgarinë Jugore. Punimi i doktoranturës së Bojka Sokollovës është në botim e sipër dhe është mjaft me interes.

Në vitin 1979 Akademia e Shkencave të Bullgarisë-Instituti Ballkanologjik botoi veprën e Bojka Sokolloves *Shtypi i Rilindjes shqiptare në Bullgari*. Kjo është vepra e parë e botuar që ka të bëjë me shtypin e Rilindjes Kombëtare shqiptare në Bullgari. Autori gjerësisht i bënë një analizë të thellë këtij shtypi. Në veprë posaçërisht flitet për gazetatat dhe revistat pastaj edhe për botimet e ndryshme të botuara në periudhën e Rilindjes. B. Sokollova analizon dhe paraqet në pah tematikën dhe problemet që ka rrahë shtypi shqiptar në Bullgari në kohën e Rilindjes. Prandaj kjo veprë ka rëndësi të veçantë në rend të parë për njohjen e opinionit shkencor bullgar si dhe të vendeve tjera me fillimet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si dhe me pllatformën e saj politike dhe shoqërore.

Rilindja Kombëtare Shqiptare ka zgjuar interes të madh në historiografinë ballkanike dhe ate botërore, prandaj vepra e autorit në fjalë është një kontribut me rëndësi për ndriçimin sa më të gjerë të Rilindjes Kombëtare në tërësi e veçanërisht të shtypi shqiptar të Rilindjes në Bullgari. Autori flet edhe për patriotët dhe përfaqësuesit e lëvizjes kombëtare që vepronin në atë kohë në bullgari.

Për hartimin e kësaj vepre autori ka përdorë një bibliografi të gjerë, burime të botuara dhe të pabotuara, një literaturë të gjerë historiografike dhe letrare. Në këtë

vend shtypi i atëhershëm zënë vend me rëndësi. Gjithashtu autori ka përdorur vepra të ndryshme nga autorët shqiptarë. Kjo veprë është e ndarë në këtë mënyrë: Në hyrje, kreu i parë që përfshinë disa nëntituj: *Vetitë karakteristike të Rilindjes Shqiptare, Veprimtaria e rilindasëve ndaj Perandorisë osmane; Veprimtaria e rilindësve shqiptarë në Rumani; Veprimtaria e rilindësve shqiptarë në Bullgari dhe Kolonia shqiptare në Sofje 1900-1912*. Në kreun e dytë: *Platforma politike në punimet dhe në shtypin e emigrantëve shqiptarë në Bullgari që nga fillimi i shekullit XX deri në çlirimin e Shqipërisë nga Perandoria Osmane 1912*. janë edhe këta nëntituj: *Botimet e përkohëshme të kolonisë shqiptare në Sofje; Shtypi i shqiptarëve të emigruar lidhur me çështjet themelore të revolucionit; Shtypi dhe marrëdhëniet e patriotëve shqiptarë ndaj revolucionit të turqëve të rinjë, çështjet shoqërore ekonomike dhe sociale në shtypin shqiptarë i botuar në Bullgari*.

Në kreun e tretë: *Programi politik i jashtëm në punimet e botuara në shtypin shqiptarë në Bullgari* janë edhe këta nëntituj: *Shqiptarët në planet e jashtme politike të fuqive të mëdha; Gazeta „Drita“ për politikën e Austro-Hungarisë dhe Italisë; „Shqypeja e Shqypënisë“, „Kalendari kombiar“ dhe „Lirija e Shqipërisë“ për politikën e fuqive të mëdha në Shqipëri; Shtypi i emigrantëve shqiptarë në Bullgari dhe Shtypi për çështjen e bashkimit dhe luftës për liri dhe pavarësi*.

Në kreun e katërt *Shtypi i emigrantëve shqiptarë në Bullgari për zhvillimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe* janë edhe këta nëntituj: *Roli i shtypit në zhvillimin e arsimit shqiptar; Roli i shtypit në formimin dhe zhvillimin e normave jugore në gjuhën letrare shqiptare; Shtypshkronja „Mbrothësija“ dhe botimet e emigrantëve në zhvillimin e letërsisë shqiptare etj. Në fund autori ka dhënë përfundimet, rezyemet dhe bibliografinë*.

Në hyrje B. Sokollova flet për kushtet shoqërore, ekonomike dhe politike të brendshme dhe situatën e jashtëme ndërkombëtare në të cilat zhvillohet Lëvizja Nacionalçlirimtare Shqiptare në periudhën e Rilindjes. Flitet për marrëdhëniet ndërkombëtare në Evropë dhe Ballkan si edhe për qëndrimin e shteteve të mëdha dhe atyre ballkanike ndaj shqiptarëve dhe çështjes shqiptare. Autori konstaton se Lëvizja Kombëtare Shqiptare zhvillohet në kushtet specifike dhe mjaft të ndërlikuara. Në periudhën e Rilindjes edhe në Bullgari shqiptarët e emigruar kanë dhënë kontribut të madh në fushën arsimore dhe kulturele për ngritjen e vetëdijes nacionale. Janë botuar libra, tekste shkollore, punime, revista dhe gazeta të ndryshme të cilat kanë luajt rol të madh propagandistik në zhvillimin dhe forcimin e intensitetit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në hyrje autori thekson qëllimin e kësaj vepre e cila ka të bëjë me veprimtarinë kulturele, arsimore dhe politike të patriotëve shqiptarë në Bullgari, me rolin e shtypit të revistave dhe gazetave në zhvillimin e Rilindjes Kombëtare dhe me vetë patriotët shqiptarë që vepronin në Bullgari dhe rolin e tyre në zgjimin kombëtar.

Në kreun e parë (9-60) autori shkruan për qendrat e Rilindjes Kombëtare; karakteristikat themelore të Rilindjes Shqiptare; Veprimtaria e rilindësve kundër Perandorisë osmane; zhvillimi i Rilindjes në Bullgari dhe në Rumani si dhe për koloninë shqiptare në Sofje 1900-1912.

B. Sokollova në këtë kaptinë shkruan për kushtet ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturele e asimore te shqiptarët që ishin nën sundimin osmanë duke filluar prej xhek. XIX deri në vitin 1912. Për sistemin feudal Osman, kushtet e rënda, shfrytëzimin ekonomik dhe shtypjen nacionale nga pushteti turk. Autori flet për marrëdhëniet shoqërore te shqiptarët, për klasat shoqërore, ndasitë fetare, pastaj për zhvillimin ekonomik, zejtarinë, tregtinë dhe bujqësinë. Ajo me vend paraqet kohën e zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste mu në 30-40 vjetët e shek. XIX në kohën e reformave të Tanzimatit. Autori i kushton kujdes të veçantë rezistencës së shqiptarëve kundër sundimit osman dhe zhvillimit të kulturës e arsimit. Kjo është koha e paraqitjes së patriotëve dhe ideologëve të parë të Rilindjes Kombëtare Viçilharxhit, Jubanit, Vretos, Kristoforidhit e të tjerëve, të cilët formuluan platformën politike dhe ideologjike të Lëvizjes Nacionalçlirimtare Shqiptare. Ata në punimet dhe veprimtarinë e tyre kanë parashtruar kërkesat fundamentale para pushtetit Osman: zhvillimin e arsimit dhe të kulturës në gjuhën shqipe, hapjen e shkollave

shqipe, alfabetin shqip, përdorimin e gjuhës shqipe në kishë dhe në institucionet tjera. Rilindësit e parë kanë paraqitur kërkesën për autonomi dhe pavarësi. B. Sokollova në mënyrë të drejtë pohon se Rilindja kulturele shqiptare dhe Lëvizja Nacionalçlirimtare fillon në 30 dhe 40 vjetët e shek. XIX-të gjë që e njëjta lëvizje zhvillohet edhe te popujt tjerë fqinjë të Ballkanit që bënin luftë për liri dhe pavarësi. Autori thekson se në intensitetin dhe fuqinë e Lëvizjes Nacionalçlirimtare ka ndikuar negativisht situata ndërkombëtare, pretendimet e fuqive të mëdha dhe të borgjezive ballkanike ndaj tokave shqiptare. Këto qëllime pushtuese kanë penguar zhvillimin e shpejtë të lëvizjes kombëtare.

Në këtë kaptinë autori flet për zhvillimin e Rilindjes Kombëtare në 50 dhe 60 vjetët e shek. XIX, për kryengritjet dhe veprimtarinë e patriotëve shqiptarë sidomos të atyre që ishin në Stamboll dhe në vende tjera Pashko Vasa, Konstantin Kristoforidhi, Hoxha Hasan Tahsini, Jani Vretua, Zef Jubani të cilët bënin përpjekje të mëdha për hartimin e alfabetit shqip etj.

Kriza e madhe lindore 1875-1878 krijoi një situatë dhe kushte të reja në Ballkan dhe në Evropë. Në këtë kohë Lëvizja Kombëtare Shqiptare pohon autori mori përpjestime të mëdha. Autori rëndësi të veçantë i kushton „Komitetit të Stambollit” i cili pat ndikim të madh në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e cila luajti rol vendimtar në luftë për autonomi dhe pavarësi. Lidhja Shqiptare e Prizrenit lëvizjen kombëtare shqiptare e ngiti në shkallën më të lartë. Komiteti i Stambollit dhe lidhja e Prizrenit me patriotët më të njohur Abdyl Bej Frashërin, Sami Frashërin, Pashko Vasën, Jani Vretuan, Zija Prishtinën e të tjerë formuluan platformën politike dhe organizuan luftën nën udhëheqjen e Lidhjes për autonomi dhe pavarësi. Autori thekson se Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka pasur për qëllim ruajtjen e tërësisë tokësore dhe bashkimin e shqiptarëve me një shtet autonom në fillim në kuadrin e Perandorisë Osmane e më vonë të lirë dhe të pavarur.

Autori i kushton kujdes të veçantë veprimtarisë së „Shoqërisë së Stambollit”, gazetës „Drita” dhe veprimtarisë së vëllëzërve, Abdyl, Naim dhe Sami Frashëri, pastaj Pashko Vasës e të tjerë. Shkruan për veprat e tyre të cilët patën rëndësi të madhe për Rilindjen kombëtare shqiptare.

Me nëntitullin *Veprimtaria e rilindësve shqiptarë në Rumani* autori flet për patriotët shqiptarë, të cilët vepronin në Bukuresht Konstancë dhe vende të tjera të Rumanisë, sidomos flet gjerësisht për Naum Viçilharxhin i cili formuloi platformën ideologjike dhe

politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në tekst flitet për veprimtarinë e Naumit dhe lidhjet e tij që kishte më atëdheun dhe me punëtorët e Lëvizjes Nacionalçlirimtarë të popujve tjerë sidomos me ata të rumanisë me Tudor Vladimireskun dhe Aleksandër Ipsilantin. Naum Viçilharxhi ka pasur lidhje edhe me disa bullgarë përparimtarë dhe të arsimuar me Ivan Seliminskim dhe të tjerë Naum Viçilharxhi ka pasur përkrahje të madhe nga një numër i konsiderueshëm të shqiptarëve të pasur si psh. prej Anastas Lijakqe Avramidit, Vangjel Zapës prej Konstantin Eftimiut e të tjerëve. Në Bukuresht në 80 vjetët e shek. XIX ka ardhur Pollo Meksi, i cili ka qenë aktivist i madh i „Shoqërisë së Stambollit”. Në këtë kohë autori thekson se rilindësit shqiptarë Naim Frashëri, Sami Frashëri dhe të tjerë kanë shkruar veprat më të njohura që kanë luajt rol të madh në forcimin e lëvizjes nacionalçlirimtare dhe verëdijes kombëtare.

Në Bukuresht vepronin Jani Vretua, Pandel Sotiri, e të tjerë. Në vitin 1884 u formua Shoqëria „Drita” rreth së cilës grumbulloheshin patriotët shqiptarë. Autori sidomos flet për veprimtarinë e madhe të Nikolla Naços. Shoqëria *Drita* më vonë e mori emërin *Diuria* e cila vazhdon punën patriotike në Rumani. Në Bukuresht dilte nga shtypi gazeta *Shqipëria* në të cilën botoheshin artikuj të patriotëve shqiptarë si dhe memorandumet që i dërgoheshin, fuqive të mëdha lidhur me çështjen shqiptare. Në të është botuar memorandum i njohur i Bukureshtit në vitin 1897. Në gazetën *Shqipëria* vepronin shkrimtarët Thona Avrami, Jani Vretua, Thimi Mitko, Zef Skiroi, Adam Shkaba, Anselm Lorekio e të tjerë. Shoqëria „*Diuria*” dhe patriotët e Rumanisë mbanin lidhje me qendrat patriotike të vendeve të tjera: me Stambollin, me Kairon, Bostonin, Sofjen dhe vende tjera. Në Bukuresht në vitin 1898 doli nga shtypi *Yll'i Shqipërisë*, që dilte në gjuhën shqipe, greqishte dhe frengjishte. Autori në vepër gjerësisht flet për veprimtarinë patriotike të Dervish Himës, i cili ka qenë iniciator në dhënien e të përkohëshmës *L'Independenca albanaise* në të cilën botoheshin artikuj të ndryshëm. Në Bukuresht në vitin 1899 u formua edhe Shoqëria *Shpresa* e studentëve shqiptarë e cila nxirrte organin *Përlindja shqiptare*. Më vonë nga viti 1906 të gjitha shoqëritë patriotike u bashkuan me emërin *Tomori* e më vonë *Bashkimi*. Sipas autorit e gjithë veprimtaria e patriotëve shqiptarë në Rumani kishte për qëllim mbrojtjen e interesave kombëtare shqiptare.

Autori në vepër e vet i ka kushtuar rëndësi të veçantë veprimtarisë të rilindësve dhe

Lëvizjes Kombëtare që u zhvillua në atë kohë në Bullgari. Siç dihet pas Kongresit të Berlinit (1878) u formua Principata Bullgare e më vonë me 1885 u bë bashkimi i Bullgarisë. Në Bullgari ekzistonin kushte për veprimtarinë patriotike të patriotëve shqiptarë. Duhet theksuar se në atë kohë në Bullgari vepronin edhe disa bullgarë letrarë dhe ideologë përparimtarë, siç ishin Dimitër Bllagojevi, Hristo Botevi etj. Autori thekson se emigrantët shqiptarë jetonin në Sofje. Pllovddiv, në Varna, në Plevën dhe në Rilla. Thekson autori patriotët më të njohur Kosta Jani Trebicken, Josif Bagerin, Kristo Luaracin, Spiro Garo, Adam Shkaben, Shahin Kolonjen. Mithat Frashëri. Jusuf Ali Beun e të tjerë. Sipas autorit Jusuf Ali Beu ka qenë lider i shqiptarëve në Sofje, i cili ishte parapaguar në gazetën *Shkipitari* që dilte në Bukuresht. Jusuf Ali Beu botonte në Sofje gazetën *Itifak*. Në atë kohë në Sofje dilte gazeta e njohur *Shkypeja e Shkypenisë* në të cilën botoheshin artikuj me përmbajtje patriotike sidomos të Josif Bagerit e të tjerëve. Patriotët dhe shoqëritë shqiptare të Sofjes kishin lidhje të ngushtë me patriotët dhe shoqëritë e Bukureshtit. Kristo Luarasi, Kosta Jani Trebicka dhe Adam Shkaba mësonin nga Nikolla Naço. Autori thekson se emigrantët shqiptarë në Sofje kishin një pjekuri të lartë politike dhe qëndrime të drejta lidhur me çështjen shqiptare, prandaj ata mbanin lidhje të ngushta me shoqëritë dhe patriotët e vendeve tjera si me *Vatrën* e Amerikës me shoqëritë e Stambollit, të Bukureshtit dhe vendeve tjera. Në Sofje ekzistonte edhe shtypshkronja e Kristo Luarasit *Mbrothësia* në të cilën u botuan shumë vepra, gazeta, revista dhe punime tjera të patriotëve shqiptarë. Atëherë doli na shtypi *Ditërefenjësi (Kalendari)* pastaj *Kalendari kombiar* e të tjera. Më vonë nga shtypi dilte edhe *Lirija*. Autori i ka kushtuar kujdes të veçantë veprimtarisë patriotike të Josif Bagerit dhe Shahin Kolonjës dhe gazetës së tij „Drita” e cila ka luajtur rol të madh në veprimtarinë patriotike. Vend të veçantë në vepër i ka kushtuar veprimtarisë së kolonisë shqiptare në Sofje në vitet 1900-1912. Patriotët dhe shoqëritë shqiptare sipas autorit në Sofje përveç punës patriotike organizonin edhe një veprimtari të madhe kulturale. Në Sofje vepronte grupi teatral, i cili përgaditi dramën në gjuhën bullgare *Besa* të Sami Frshërit, pastaj *Vdekja e Piros* e Mihajl Gramenos e tjera. Në tubime lexoheshin vjershat e Naim Frashërit, Hristo Botevit dhe poetëve të tjerë. Në shoqëritë shqiptare në Bullgari bëri influencë të madhe „Komiteti shqiptar për lirinë e Shqipërisë” i formuar në Manastir në vitin 1905.

Në kaptinën e dytë autori flet për platformën politike e cila paraqitet në veprimtarinë e patriotëve shqiptarë në Bullgari dhe në vende tjera. Patriotët dhe shoqëritë patriotike shqiptare në veprat dhe gazetat që botonin kërkonin bashkimin e popullit shqiptar në një shtet të lirë dhe të pavarur. Krijimin e një gjuhe të përbashkët, bashkimin e kishës shqiptare me një gjuhë të përbashkët dhe të një alfabetit të përbashkët. E gjithë kjo veprimtari sipas autorit ka qenë e orientuar në ruajtjen e tërësisë tokësore të vendeve të banuara me shqiptarë si dhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare shqiptare. Patriotët shqiptarë në Bullgari dhe në Rumani në veprat e tyre kritikonin ashpër regjimin e kalbur të Perandorisë osmane dhe kërkonin shkatërrimin e saj. Ata kritikonin ashpër pretendimet e shteteve të mëdha dhe të atyre ballkanike ndaj tokave shqiptare. Vihet në pah rreziku i Panhelenizmit grek dhe i borgjezive ballkanike ndaj tokave shqiptare. Autori sidomos i kushton kujdes shtypit të emigrantëve shqiptar që dilte në Bullgari dhe në Rumani. I bënë një analizë të gjerë artikujve të botuar në gazetën „Drita”, në të përkohëshmen *Shkipërija*, pastaj *Lirija*, *Rrufaja*, *Shkopi* e të tjera, në të cilat botoheshin artikuj me përmbajtje patriotike lidhur me çështjen shqiptare. Sidomos në këtë drejtim sipas autorit ka luajtur rol *Drita* e Shahin Kolonjës.” Në një nëntitull të veçantë autori flet për qëndrimin e patriotëve shqiptarë të Bullgarisë dhe Rumanisë ndaj revolucionit të turqëve të rinj. Në artikuj të ndryshëm që botohen në gazetë, që dilnin në Bullgari dhe në Rumani, patriotët shqiptarë kritikonin ashpër regjimin e turqëve të rinj i cili nuk i solli asgjë popullit shqiptarë. Janë të njohur artikujt që botohen në gazetën *Drita* në *Shkypeja* e *Shkypërisë* dhe në të tjera kundër regjimit të turqëve të rinj.

Autori në veprën e përmendur ka shkruar edhe për çështjet ekonomike dhe sociale, të cilat janë shkruar në shtypin e patriotëve shqiptarë, për pozitën e vështirë ekonomike dhe shoqërore të popullit shqiptarë nën sundimin turk.

Në kaptinën e tretë autori gjerësisht ka shkruar për pozitën e popullit shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare për pretendimet veçanërisht të Austro-Hungarisë, Italisë, dhe shteteve ballkanike ndaj tokave shqiptare. Në shtypin e patriotëve shqiptarë sidomos në *Drita* e Shahin Kolonjës kritiko-

het ashpër politika e Austro-Hungarisë, e Italisë, Greqisë, dhe Serbisë ndaj tokave shqiptare. Në një nëntitull të veçantë autori e bënë një analizë për artikujt e botuar në *Shkypën* e *Shkypënisë* në *Kalendar Kombiar* dhe në *Liri* e *Shkipërisë* në të cilat botohen artikujt në të cilët kritikohet ashpër politika e shteteve të mëdha dhe atyre ballkanike lidhur me çështjen shqiptare.

Në kapitullin e katërt autori flet për rolin e shtypit shqiptar në Bullgari në zhvillimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, sidomos thekson rolin e shtypit në zhvillimin e shkollës shqipe. Në këtë kaptinë bëhet një analizë e gjerë e veprimtarisë letrare si dhe në veprimtarinë botuese të teksteve shkollorë.

Sipas autorit patriotët shqiptarë që vepronin në Bullgari, Rumani, dhe vende tjera kanë dhënë një kontribut të madh për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës së popullit shqiptar. Kontributi i tyre është më i madh në fushën politike dhe ideologjike lidhur me çështjen shqiptare, prandaj e gjithë veprimtaria politike, ideologjike dhe letrare e patriotëve shqiptarë në Bullgari dhe në Rumani sipas autorit është një kontribut i madh për Rilindjen Kombëtare dhe për lëvizjen nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.

Në këtë recension të shkurtër nuk kam pasur për qëllim të bëjë një analizë të gjerë të veprës së Bojka Sokollovës, por më tepër kam pasur për qëllim të vijë në pah rëndësinë e kësaj vepre që ka të bëjë me Rilindjen Kombëtare shqiptare. Sokollova përveç në tërësi ka shkruar për veprimtarinë patriotike të Rilindësve shqiptarë në Bullgari ajo ka vu në pah të dhëna të reja që kanë rëndësi për kulturën e letërsisë dhe historiografinë shqiptare. Me këtë vepër ajo ka dhënë një kontribut me rëndësi në ndriçimin e veprimtarisë patriotike të patriotëve shqiptarë, të cilët kanë vepruar në kohën e Rilindjes në Bullgari dhe Rumani. Ky kontribut pa dyshim ka një vlerë të lartë shkencore. Është e dijtur se Sokollova nuk ka pasur pretendime ta thotë fjalën e fundit për veprimtarinë patriotike të shqiptarëve të Bullgarisë dhe Rumanisë, mirëpo kjo është vepër e parë prej së cilës duhet nisur për hulumtime të mëtejshme në studimin e veprimtarisë politike, ideologjike, letrare të patriotëve shqiptarë të Bullgarisë.

EMIN PILLANA